

Ekonomia Qarkore në Kosovë

*Hulumtim mbi njohurinë dhe perceptimin e përgjithshëm
rreth konceptit të ekonomisë qarkore në Kosovë*

Punuar nga: Annea Hapçiu
News Agency KosovaLive, Tetor 2019



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	2
Metodologjia.....	3
Informimi mbi Ekonominë Qarkore	4
Pengesat në zhvillimin e Ekonomisë Qarkore në Kosovë.....	6
Mundësitë për nxitjen e zhvillimit të Ekonomisë Qarkore.....	8
Raporti i Kulturës dhe Sjelljeve në krijimin e një atmosfere për lulëzimin e Ekonomisë Qarkore.....	9
Përfundim	10
Rekomandime.....	10
Përshtypjet nga Konferenca e Parë Nacionale mbi Ekonominë Qarkore, mbajtur më shtator 2019 në Prishtinë.....	12
Rreth News Agency KosovaLive (KosovaLive).....	14
Rreth Autores	14
Referencat	15

Hyrje

Esenca e ekonomisë qarkore reflektohet në tendencën e njerëzimit të arrijë që ta mimikojë sistemin ekonomik, mbi të cilin funksionon natyra – ku lëndët e para që hyjnë në krijimin e një produkti në natyrë nuk humben, por vetëm transformohen nga një formë në tjetrën. Në përballje me mbipopullimin, stërpërdorimin e resurseve finite, degradimin ambiental dhe ndikimin në mirëqenien e njerëzimit, shihet qartë që sistemi ekonomik linear që filloi para disa qindra vitesh, dhe mori hov nga revolucioni industrial e tutje, nuk është i qëndrueshëm për të akomoduar ndryshimet ambientale me të cilat do të ballafaqohet njerëzimi në afatgjatë.

Qëllimi i ekonomisë qarkore është të ofrojë një alternativë përballë ekonomisë lineare, e cila bazohet në *Prodhim-Konsumim-Hedhje* në një sistem ekonomik ku fokusi është në dizajnimin e produkteve me një qasje *Rigjeneruese dhe Rikthyese* në sistemin e prodhimit dhe konsumimit, me fokus në *Prodhim-Konsumim-Ripërdorim*. Qëllimi i ekonomisë qarkore është përdorimi i lëndëve të para aq të pastërta sa që mund të ri-reciklohen në vazhdimësi. Ky sistem ekonomik ka për qëllim eliminimin e mbetjeve dhe përdorimin sa më efikas të resurseve për prodhim.

Koncepti ideor i këtij sistemi ekonomik ka ekzistuar në formate të ndryshme që nga mesi i viteve të '60-ta, por në përballje me ngrohjen globale, ndryshimet klimatike, e mbishfrytëzimin e resurseve finite, është duke marrë formë më integruese dhe duke u ritheksuar gjithnjë e më tepër, si alternativë e qëndrueshme përballë sistemit ekonomik linear.

Koncepti i ekonomisë qarkore në shtetet në zhvillim është duke u studiuar e rafinuar, përderisa modalitetet për kalim në këtë lloj të ekonomisë janë duke u shqyrtuar e testuar, me qëllim të sigurimit të një modeli ekonomik të qëndrueshmërisë së jetës njerëzore për një periudhë afatgjatë.

Në Kosovë fillet e kësaj ekonomie shihen të shpërndara, në disa iniciativa të kompanive në sektorin privat, në diskutimet sipërfaqësore nga organizatat joqeveritare, dhe me një vizion të mangët nga qeveria për të zhvilluar këtë sistem në vend. Iniciativat për zhvillim ekonomik duket se janë të përqendruara me intensitet në ndërtimin e një ekonomie më konkurrenente duke mbindërtuar shumë më shumë e më shpejtë mbi ekonominë lineare, sesa në krijimin e një ambienti që do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes modeleve qarkore.

Përveç që mungon njohja me terminologjinë e këtij koncepti nga masa, mungon edhe kuptimi i thellë i esencës së ekonomisë qarkore, si dhe komponentet ndërtuese, që mundësojnë zhvillimin e saj. Përderisa shihet një vetëdijësim dhe një dashamirësi për ambientin, mungon kuptimi holistik mbi mënyrën se si veprimet e ndryshme biznesore, e zgjedhjet vetanake ndërveprojnë me mirëqenien holistike njerëzore dhe ambientin, që mundëson ekzistencën. Gjithashtu shihet që mungon një besim individual që mund të ndryshojë kahjen e ekonomisë dhe një varësi në mbështetje për stimulim nga organet shtetërore.

Metodologjia

Hulumtimi për perceptimet dhe dijen e përgjithshme të banorëve të Kosovës për konceptin e Ekonomisë Qarkore është zhvilluar përgjatë një periudhe tre mujore, nga muaji maj deri në gusht të vitit 2019.

Të dhënat që mbështesin këtë hulumtim, janë mbledhur përmes hulumtimit primar, të udhëhequr përmes anketës së distribuuar në mënyrë elektronike, në media sociale dhe në email. Ky raport është bazuar në masë të madhe në hulumtimin primar që është bërë për këtë raport, për shkak të mungesës së raporteve e hulumtimeve të mëhershme që trajtojnë specifikisht çështjen e ekonomisë qarkore në vend.

Përdorimi i platformave elektronike për hulumtimin primar është bërë me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe kursimit të përdorimit të letrës dhe mjeteve të tjera që kontribuojnë në ndotjen e ambientit.

Procesi është zhvilluar kryesisht online, përmes anketës së krijuar enkas për matjen e njohurisë, perceptimeve, sjelljeve dhe përshtypjeve të banorëve të Kosovës për mundësitë dhe pengesat e zhvillimit të kësaj ekonomie në vend.

Përgjigjet në anketë kanë ardhur nga shumica e respondentëve që u identifikuan si beqar/e dhe të martuar, me një ndarje të përafërt të personave të punësuar dhe jo të punësuar.

Anketa është plotësuar vullnetarisht tërësisht nga gjithsej 462 persona nga anembanë Kosova (viset rurale e urbane), të moshave nga 15-65+ vjet, të të gjitha niveleve të edukimit nga ai parauniversitar e deri në atë terciar. Analiza e të dhënave është bërë nga sistemi për analizimin e të dhënave të inkuadruar në platformën online për mbledhjen e të dhënave dhe në SPSS për analiza më të detajizuara.

Anketa ëahtë punuar në gjuhën shqipe dhe në disa raste është dhënë edhe termi në gjuhën shqipe edhe ai në gjuhën angleze, për të vlerësuar njohurinë reale mbi konceptin, e për të evituar limitimet gjuhësore. Përfshirja gjeografike e këtij hulumtimi inkuadron respondent edhe nga viset urbane dhe rurale, duke përfaqësuar këndvështrimet nga veriu (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Glogoc), jugu (Prizren, Suharekë, Dragash), qendra (Malishevë, Shtime, Klinë, Rahovec) lindja (Prishtinë, Gjiilan, Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan, Ferizaj, Obiliq, Viti, Novobërdë,) dhe perëndimi i Kosovës (Pejë, Deçan, Gjakovë, Janjevë).

Qëllimi i studimit është që të jepet një pasqyrë fillestare për nivelin e informimit, njohurisë, perceptimeve dhe sjelljeve të qytetarëve në raport me zhvillimin e ekonomisë qarkore në Kosovë, si dhe të ofrohen rekomandime multisektoriale që mund të ndihmojnë në nxitjen e zhvillimit të këtij modeli ekonomik në vend.

Informimi mbi Ekonominë Qarkore

Shumica e të anketuarve nuk kishin dëgjuar më herët për termin “Ekonomi Qarkore”, pasi që me t’u prezantuar me termin, së paku rreth 60% të tyre u deklaruan se nuk kishin njohuri për këtë koncept ose nuk ju kujtohej. Duke marrë parasysh termin relativisht të ri në gjuhën shqipe, të anketuarit gjithashtu u pyetën se a kanë dëgjuar termin “Circular Economy”, për të bërë një matje reale të njohurisë së përgjithshme të tyre për këtë koncept - përtej limitimeve gjuhësore dhe literaturës së disponueshme për këtë fushë në gjuhën shqipe. Por, rezultatet dolën gati se identike dhe shumica nuk e kishin dëgjuar këtë term as në gjuhën angleze.

Familjarizimi me një term dhe kuptimi i plotë i atij koncepti kanë dallim thelbësorë dhe ndikojnë në vetëdijën e tërësishme të personave mbi një koncept të studiuar. Për këtë arsye, të anketuarve më pastaj iu prezantua definicioni i ekonomisë qarkore në gjuhën shqipe dhe u pyetën se a kanë diskutuar ndonjëherë në shkollë/universitet për këtë koncept. Esenca ishte të kuptohej se sa thellësisht kanë njohuri për këtë koncept qytetarët e Kosovës. Rezultatet treguan se edhe pse më shumë persona kishin dëgjuar për termin e ekonomisë qarkore, shumica dërmuese (mbi 70%) e tyre pohuan se nuk kishin diskutuar ndonjëherë për këtë sistem ekonomik në shkollë/universitet apo se nuk ju kujtohej. Në fshatra dhe në vise më të izoluara, sikurse Malisheva, Vitia, Deçani e Skenderaj mungesa e njohurisë për këtë koncept ishte dukshëm më e lartë.

Për të matur njohurinë më thellësisht, kur u pyetën respondentët për qasjet e ndryshme me të cilat janë të familjarizuar e që kontribuojnë në ndërtimin e ekonomisë qarkore, hulumtimi reflektoi një mungesë të thellë të dijeve, ku shumica nuk ishin në gjendje të identifikonin strukturat konceptuale që mundësojnë krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë qarkore.

Rreth 36% e respondentëve nuk kishin dëgjuar kurrë për asnjërin nga konceptet që kontribuojnë në ndërtimin e ekonomisë qarkore. Vetëm rreth 1.3% kishin dëgjuar për të gjitha.

Për, *Biomimikrinë* (Biomimicry), një disiplinë e re që studion idetë më të mira nga natyra dhe imiton ato dizajne dhe procese për të zgjidhur probleme, e që konsiderohet si një nga bazat e ndërtimit të ekonomisë qarkore, respondentët kishin pak njohuri në përgjithësi. Vetëm rreth 6% e të anketuarve kishin dëgjuar për këtë term. Kjo disiplinë që ka për qëllim të frymëzohet nga natyra për të inovuar - për shembull të studiojë funksionimin e gjetheve për të krijuar qeliza solare më efektive - ishte shumë e panjohur sidomos në fshatra, e në vendet më të izoluara të Kosovës.

Qëllimi i ekonomisë qarkore është të ndryshojë rrënjësisht nga ekonomia lineare ku “Prodhojmë-Konsumojmë-Gjuajmë” në një ekonomi që e mimikon natyrën dhe asgjë nuk “shkon huq” duke u hedhur por në mënyrë të qëndrueshme dhe të shëndoshë ri-inkorporohet në sistemin e prodhimit dhe konsumimit, duke evituar hudhjen. Kjo qasje e inovacionit dhe e kontributit ekonomik përmes krijimit të produkteve e proceseve në përputhje me modelet natyrore, përbën një nga themelet e ekonomisë qarkore dhe është po thuajse aspak e njohur në Kosovë.

Ngjashëm, vetëm rreth 15% e respondentëve kishin dëgjuar për *Ekonominë e Kaltërt* (Blue Economy), që ka për qëllim t’i përdorë resurset në dispozicion, dhe të përdorë resurset e oqeanit për zhvillim ekonomik, përmirësim të jetesës dhe rritje të punësimit, duke mbrojtur shëndetin e ekosistemeve oqeanike. Në ballafaqim me mungesën e hapësirave për deponi dhe dëshirën për mbrojtjen e tokës, shpeshherë oqeanet dhe ujërat bëhen viktima të ekonomisë lineare duke e marrë rolin e deponive ilegale.

Qëllimi i Ekonomisë Qarkore është të shtyjë përpara mendësinë për vetëdije se toka funksionon si tërësi dhe ndikimi negativ në një anë pa dyshim se do të ketë efekt edhe në ndonjë aspekt tjetër të jetës në tokë. Për këtë arsye modaliteti i funksionimit të ekonomisë lineare, ku prodhojmë-konsumojmë-hedhim, duke i keqpërdorur ujërat, nuk është i qëndrueshëm. Edhe për këtë koncept, të anketuarit në Kosovë, kishin njohuri shumë të mangët.

Njëkohësisht, për qasjen *Djep në Djep* (Cradle to Cradle), kishin dëgjuar vetëm rreth 4%, që është më së paku nga të gjitha konceptet. Ky proces ndjek një qasje biomimetike për dizajnimin e produkteve dhe sistemeve, që modelojnë industrinë njerëzore mbi proceset natyrore, që shohin secilin material si nutricion, duke qarkulluar në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurtë nga një proces në tjetrin, që nga prodhimi, konsumimi e deri te ri-inkuadrimi në cikël për ripërdorim. Ky nivel i ulët i njohurisë rreth këtij koncepti, përputhet me përgjigjet e mëparshme ku u analizua se sa diskutohet për ekonominë qarkore në shkolla e universitet, pasi që baza e njohurisë mbi këto koncepte zakonisht fillon të mësohet e analizohet më thellësisht në kontekste akademike.

Më shumë respondentë ishin të familjarizuar me konceptet e *Ekologjisë Industriale* (Industrial Ecology), që merret me studimin e materialeve dhe qarkullimeve energjetike përmes sistemeve industriale. Rreth 45% deklaruan se kishin dëgjuar për ekologjinë industriale. Qëllimi i kësaj qasjeje është që të krijojë procese me një “Lak të mbyllur”, ku asnjë material nuk humbet, e nuk hudhet në fund, por jeta i vazhdon në një formë qarkore, duke u përdorur e ripërdorur nga një fazë e jetës në tjetrën. Sa e kanë ndërlidhë këtë terminologji me definicionin që i përket ekonomisë qarkore, e sa e kanë ndërlidhë me termet e tjera që ekzistojnë në gjuhën tonë, por kanë kuptime të tjera, mund të jetë një limitim i gjuhës, që duhet të merret parasysh për studime të tilla, ku koncepti i sistemit i cili analizohet nuk figuron në legjislacion dhe nuk është “njohuri e përgjithshme”.

Për qasjen e *Mendimit në Sisteme* (Systems Thinking) kishin dëgjuar gjithashtu më pak se 20% e të anketuarve. Mendimi në Sisteme është qasje e cila përdoret për të kuptuar ndikimin e elementeve njëra me tjetrën dhe tërësinë. Me këtë qasje konsiderohet vendi i elementeve të caktuara në raport me ambientin, infrastrukturën dhe kontekstin në të cilin vendoset elementi. Ekonomia Qarkore mund të funksionalizohet vetëm nëse përputhet mendësia me mendimin në sisteme.

Respondentët kishin dëgjuar më tepër për qasjen me *Rregullat e Biosferës* (Biosphere Rules), e cila merret me implementimin e “Laqeve të mbyllura” në proceset e prodhimit të cilat origjinojnë nga sistemet natyrore dhe përkthehen në sisteme të prodhimit industrial, pasi që rreth një e treta e të anketuarve përzgjedhën këtë qasje si të njohur për ta. Njëherësh, edhe këtu duhet të kemi parasysh, që për shkak të limitimit gjuhësor, kjo terminologji mund të jetë asociuar edhe me koncepte të tjera që zakonisht mësohen në lëndën e Biologjisë, edhe pse për ta qartësuar termin është ofruar terminologjia në gjuhën angleze.

Rreth 80% të respondentëve asnjëherë nuk kishin ndjekur ndonjë punëtori(trajnim) të *Mendimit Dizejnuës* (design thinking), metodologji e inovacionit që ka për fokus zgjidhjen e problemeve në mënyrë kreative dhe që shpeshherë përdoret për të zgjidhur probleme të krijuara nga dizajnet joefektive që ndikojnë negativisht mbi ambientin, duke krijuar joeficienca shoqërore e biznesore. Një limitim gjuhësor që mund të ketë ndikuar në përgjigje mund të jetë edhe termi “design thinking”/ “mendim dizejnuës”, i cili shpeshherë po ndërlidhet edhe me kurset e dizajnit apo dizajnit grafik, për këtë duhet të kemi parasysh se kjo do të mund të ndikonte në përqindjen e respondentëve që janë përgjigjur se kanë ndjekur punëtori dhe trajnime të tilla.

Kur u pyetën për fokusin e ekonomisë qarkore, respondentët ishin të ndarë dhe vërehej qartazi mungesa e njohurisë së thellë dhe më gjithpërfshirëse mbi këtë temë. Shumica dërmuese e të anketuarve mendojnë se ekonomia qarkore ka fokus reciklimin (66%), por kjo e fundit, edhe pse është një praktikë që prek sipërfaqësisht këtë sistem ekonomik, për shkak se momentalisht e ka fokusin në reciklimin e resurseve finite, nuk është thelbi i saj.

Sipas EllenMacArthur Foundation, ekonomia qarkore shikon përtej modelit të ekonomisë lineare, që fokusohet në sistemin industrial nxjerrës me fokus Merr-Krijo-Hedh, (Take-Make-Waste), duke u munduar të rerefinojë zhvillimin.

Qëllim i ekonomisë qarkore është të kalojë nga konsumimi i resurseve finite në dizajnimin e mbetjes krejtësisht jashtë sistemit. Për këtë arsye, reciklimi i produkteve që përdorin resurse

finite si lëndë të parë nuk eliminon konsumimin e resurseve finite, për shkak se jo çdo produkt i krijuar nga njeriu deri më tani mund të reciklohet qind për qind, dhe se për procesin e reciklimit vazhdojnë të shpenzohen shumë resurse, që ndikojnë vet në ndotjen e ambientit.¹


Pas reciklimit, të anketuarit zgjodhën “zgatjet e jetës së produktit” (rreth 37%), rreth një e treta mendojnë mendimin disejnuet (30%), dhe rreth një e katërta mendimin në sisteme (26.5%) si fokuse të tjera të ekonomisë qarkore. Ndërkaq, vetëm rreth një e katërta (24%) i shihnin të gjitha këto komponente si fokuse që mundësojnë zhvillimin e këtij sistemi ekonomik. Këto gjetje përsëri rikonfirmojnë, se në përgjithësi ka mungesë të njohurisë dhe edukimit të thellë në Kosovë mbi këtë koncept, por gjithashtu ka edhe keqkuptime për esencën e ekonomisë qarkore, gjë që mund ta parandalojë zhvillimin e suksesshëm dhe rrënjësor të këtij sistemi në Kosovë.

Pengesat në zhvillimin e Ekonomisë Qarkore në Kosovë

Rreth 70% e të anketuarve mendojnë se pengesat që e ngadalësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkore në Kosovë janë “mosnjohuria e përgjithshme” për këtë sistem dhe “mungesa e incentivave shtetërore që stimulojnë ekonominë qarkore”.

Rreth 43% besojnë se problemi qëndron te mosdëshira e bizneseve të merren me zhvillimin e ekonomisë qarkore, mungesa e qasjes në njohuri për të mësuar për mënyrën e krijimit të bizneseve që ndihmojnë në etablimin e ekonomisë qarkore (48%), dhe mungesa e iniciativës.

Më shumë se një e treta (34%) e respondentëve mendojnë se pengesë është edhe mosinteresimi i stafit të kompanive për të punuar në zhvillimin e produkteve të reja që do të mund të inkuadroheshin në këtë sistem ekonomik.



Grafikoni 1: Cilat mendon se janë pengesat që po e ngadalësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkore në Kosovë?


¹ Ellen Mac Arthur Foundation. <https://www.ellenmacarthurfoundation.org/circular-economy/concept>

Mbështetja në shtet shihet të jetë një nga karakteristikat e përgjigjeve, perceptimeve, dhe dëshirave të përmbledhura nga ky studim, kur vjen tek zhvillimi i ekonomisë qarkore.

Reciklimi tradicional edhe pse është i bazuar në menaxhimin e pasojave të krijuara nga ekonomia lineare, mund të konsiderohet si një nga hapat e parë për të krijuar një mentalitet kujdesi tek njerëzit dhe për këtë arsye ka qenë një nga pyetjet drejtuar të anketuarve në këtë studim. Në Kosovë, reciklimi mezi që ekziston dhe bëhet në mënyrë sporadike, duke mos qenë praktikë e përgjithshme e familjeve apo bizneseve. Vetëdija për nevojën e reciklimit mund të sjellë me vete vetëdijen për përgjegjësinë e dizajnit me bazë biomimetike. Për më tepër mund të krijoj vetëdije për pasojat e mos menaxhimit të vetëdijshëm të produktit në fund të jetës.

Shumica e respondentëve në anketë (rreth 60%) besojnë se një nga mënyrat më efektive për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në reciklim në Kosovë do të ishte ofrimi i incentivave financiare për reciklim (për çdo produkt që reciklojnë të merrnin para).

Kjo metodë është treguar të jetë e suksesshme për ndryshimin e sjelljes dhe kulturës së



reciklimit në shumë vende të tjera të botës, por reciklimi i tanishëm si proces nuk konsiderohet si thelb i ekonomisë qarkore. Për këtë më shumë duhet të punohet në edukimin e masës për nocionin e thellë të ekonomisë qarkore, që të kuptohet se deri në çfarë mase duhet të modifikohet sjellja dhe dizajni i produkteve e sistemeve që të mundësojnë zhvillimin e këtij sistemi në Kosovë.

Një përqindje e rreth 9% të respondentëve besojnë se problemi është te dizajnet e shportave të reciklimit dhe se rritja e reciklimit do të mundësohej me një ridizajnim të tyre.

Të tjerët mendojnë se nëse do të kishte shporta të reciklimit nëpër “hyrje”, poshtë në ndërtesat ku banojnë (15%), ose në punë (5%), ose në shkollë e universitet (8%), do të mund të rritej reciklimi në vend.

Pengesat e tjera të identifikuar ishin se mungon edukimi i mirëfilltë i popullatës për rëndësinë e reciklimit dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale qendrore e lokale për

Grafikoni 2: Cilat nga këto mënyra mendon se do të ishte efektive për krijimin e kushteve të favorshme për lulëzimin e ekonomisë qarkore në Kosovë?

mbledhjen e gjëseneve të reciklueshme. Respondentët mendojnë se edhe krijimi i modaliteteve ligjore që do të obligonte reciklimin dhe sjelljet e ngjashme do të mund të ndihmonte rritjen e pjesëmarrjes në reciklim në Kosovë. Për disa ishte e rëndësishme edhe të përcaktohej nga merrej energjia elektrike për reciklim. Përsëri, është e rëndësishme të ritheksohet se reciklimi si nocion hyn në kuadër të ekonomisë lineare. Por, është një urëlidhëse e rëndësishme për të krijuar një vetëdije te masa për ndikimin e ciklit të jetës së produkteve vetëm për një përdorim në ambient, e sidomos tek vendet si Kosova, ku jeta e produkteve pas përdorimit të tyre rrallë diskutohet.

Në përgjithësi shihet që ka një vetëdije të konsiderueshme për problemet kryesore që rezultojnë nga ekonomia lineare dhe ndikojnë në krijimin e mbeturinave dhe bërllokut. Shumica besojnë se mospasja e mundësive për menaxhim të mbeturinave (rreth 58%), përdorimi i lëndëve të para që nuk mund të reciklohen (rreth 58%), krijimi i produkteve të dobëta dhe jo të qëndrueshme (rreth 32%) dhe rritja e konsumizmit dhe e dëshirës për të poseduar gjësende materiale (28%), janë problemet thelbësore që sjellin deri tek krijimi i bërllokut.

Kjo tregon se ka një nivel të vetëdijes shoqërore për thelbin e problemit që është duke krijuar ekonomia lineare, dhe lë hapësirë për zbatimin e modelit ekonomik qarkor për të siguruar një ekonomi më të qëndrueshme, më afatgjatë, për zgjidhjen e problemeve që kontribuojnë në degradimin ambiental, shëndetësor e shoqëror.

Mundësitë për nxitjen e zhvillimit të Ekonomisë Qarkore

Kur u pyetën se çka do t'i stimulonte personat që të kyçeshin në ekonominë qarkore në Kosovë, shumica dërrmuese thanë se “dëshira për të përmirësuar hapësirat e përbashkëta do t'i shtyente për të punuar në nxitjen e zhvillimit të ekonomisë qarkore” (70%). Dëshira për të ulur ndotjen e ajrit erdhi në vendin e dytë (64%).

Ndërkaq “oportuniteti për të rritur fitimin” u listua si një nga top tre (3) mënyrat më të mira për t'i stimular personat që të kyçen në ekonominë qarkore (me rreth 60% të mbështetjes). Kjo u listua edhe më lartë se dëshira për të ulur ndotjen e ujit, e cila përfundoi si një nga top katër (4) mënyrat më të preferuara (53%)

Rreth 57% përqind e të anketuarve besojnë se krijimi i modeleve stimuluese për qytetarët e zakonshëm të marrin pjesë në krijimin e ekonomisë qarkore ishte një nga mënyrat që ata konsideruan se do të ishte më efektive për krijimin e kushteve të favorshme për lulëzimin e ekonomisë qarkore në Kosovë.

Investimi në inkuadrimin e lëndës së ekonomisë qarkore në shkolla ishte propozimi i dytë më i popullarizuar për të anketuarit, me 56% që e përzgjedhën.

Së treti përgatitja e fuqisë punëtore dhe ndërmarrësve të krijojnë biznese në përputhje me kriteret e ekonomisë qarkore u listua si nga mënyrat më të mira për të nxitur zhvillimin e këtij sistemi në Kosovë (54%)

Gjithashtu lartë u vlerësua edhe nevoja për krijimin e ekosistemit infrastrukturor që mundëson funksionimin e ekonomisë qarkore në vend (51%), si dhe krijimi i ekosistemit financiar që siguron sukses në ekonominë qarkore (44%).

Nga përgjigjet e respondentëve shihet që mundësitë për të drejtuar kahjen e zhvillimit ekonomik me fokus ekonominë qarkore janë të mundshme nëse bazohen në përmirësimin e standardit të jetesës, por njëkohësisht mundësojnë rritjen e fitimit te qytetarët.

Raporti i Kulturës dhe Sjelljeve në krijimin e një atmosfere për lulëzimin e Ekonomisë Qarkore

Gjetjet nga hulumtimi reflektojnë një mangësi të njohurisë dhe iniciativave në të gjitha nivelet e vendit që mund të krijojnë një atmosferë adekuate për zhvillimin e ekonomisë qarkore në Kosovë. Përderisa ka stagnim në fillimin e zhvillimit të ekonomisë qarkore, gjithashtu mungon menaxhimi efektiv i pasojave të ekonomisë lineare në vend.

Edhe pse shoqëria në Kosovë ripërdorë disa produkte, jetëgjatësia e produktit shkon vetëm edhe një hap më tutje, për përdorim dytësor dhe pastaj në bërllok. Ripërdorimi dhe reciklimi i produkteve të krijuara nga resurset finite është pjesë e ekonomisë lineare. Por, është një mentalitet i nevojshëm për të ndryshuar sjelljen tek njerëzit, dhe për të shtruar rrugën drejt dizajnit më efektiv dhe më të vetëdijshëm, sidomos në vendet në zhvillim e sipër si Kosova, ku reciklimi mezi që praktikohet.

Iniciativa individuale te banorët e Kosovës për ripërdorim është e limituar deri në përdorimin dytësor, për shkak se individët nuk e kanë njohurinë, teknologjinë dhe infrastrukturën në dispozicion për të ripërdorur produktet më tutje. Gjithashtu për shumë produkte, lloji i lëndës së parë që është i përdorur i limiton në reciklim.

Vetëm rreth 42% e banorëve të Kosovës, i ripërdorin ndonjëherë produktet e letrës, shishet dhe pajisjet e ndryshme të tjera. Rreth një e treta (34%) thonë se në përgjithësi ripërdorin produktet që janë të krijuara për një qëllim të caktuar, dhe një e katërta (24%) thonë se nuk i ripërdorin, pas përdorimit fillestar të tyre.



Grafikoni 3: Çka do t'i stimulonte personat që të kyçeshin në ekonominë qarkore?

Nga ata që i ripërdorin, shumica thonë se i ripërdorin shihet e ujit, të lëngjeve, dhe gavanozat për përdorim më të gjatë. Qeset e plastikës janë ndër produktet më të ripërdorshme, të cilat pas përdorimit për bartje, respondentët i shfrytëzojnë edhe njëherë për bërllok.

Ripërdorimi i produkteve ndonëse është i pranishëm në shoqëri, produkteve të ripërdorura duket se ju zgjatet jeta, vetëm edhe për një përdorim dytësorë, pas së cilit përfundojnë në deponi.

Nga ata që u deklaruan se nuk i ripërdorin gjësendet për herë të dytë, shqetësimet ishin nga mendimi se disa produkte, si shishja e plastikës janë të rrezikshme për ripërdorim, e deri tek përtesa, mungesa e njohurisë për ripërdorim apo edhe kostoja e lirë dhe qasja e lehtë te disa produkte, që nuk i stimulonin për t'i ripërdorë të vjetrat.

Nga studimi shihet qartë se pos që mungon dija për ripërdorim, mungon infrastruktura që do të mundësonte ripërdorimin, si dhe incentivat që do ta fusnin ripërdorimin dhe reciklimin si pjesë të përditshmërisë së banorëve në Kosovë.

Thelbi i ekonomisë qarkore është në eliminimin e krijimit të mbetjes tërësisht nga sistemi. Duke përdorë dizajnimin e shëndoshë biomimetik për të mundësuar ri-reciklimin e lëndëve të para dhe pjesëve të produkteve, ekonomia qarkore synon të evitoj nevojën për reciklim tradicional, si dhe pasojat e krijuara nga mbetjet dhe bërlloku në ambient dhe në shëndetin publik.

Përfundim

Përderisa të anketuarit shprehin dashamirësi për ambientin, vërehet se sjelljet konkrete drejt krijimit të ekonomisë qarkore do të rezultojnë nëse në afatshkurtë do të kishte incentiva financiare për ta, e në afatgjatë edukim gjithëpërfshirës dhe infrastrukture të qëndrueshme për të siguruar veprime konkrete.

Edhe pse vetëdija individuale për rëndësinë e ambientit është e evidente, nga përgjigjet në anketë shihet se sjellja dhe kultura mund të ndryshojnë në periudhë afatshkurtër drastikisht nëse ka intervenime në shumë nivele të cilat mund t'i motivojnë ata për të transformuar mënyrën e jetesës.

Ndërkohë që tek respondentët vërehet aftësia për identifikim të problemeve, mungon një proaktivitet individual për intervenim, pa ndonjë stimulim. Për shkak se investimi në edukim merr kohë dhe përmirësimet kërkojnë më shumë kohë, intervenimet që ofrojnë incentiva financiare apo ndëshkimet, mund të ndihmojnë në zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend në afat më të shkurtë.

Vërehet se ka nevojë urgjente për strategji multisektoriale, që përfshinë vendosjen e bazës ligjore, ekonomike, teknologjike, infrastrukturore, dhe edukative, me qëllim të ndryshimit të mentalitetit dhe kulturës në raport me qasjen ndaj prodhimit, konsumimit, hedhjes apo ripërdorimit.

Rekomandime

Koncepti i ekonomisë qarkore në vetvete parasheh qasje holistike në zgjidhjen e problemeve, duke iu qasur problemit që nga shtyllat krijuese dhe deri te ndikimi i gjerë i tij. Për këtë arsye, për të mundësuar krijimin e ambientit të favorshëm për etablimin dhe lulëzimin e ekonomisë qarkore, nevojiten intervenime të koordinuara dhe paralele, që ndikojnë në ndryshimin e mentalitetit dhe sjelljes në nivelin personal, shoqëror dhe shtetëror.

Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2020, e hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në janar të vitit 2016, nuk e përmend termin e ekonomisë qarkore dhe nuk e parasheh zhvillimin thellësor holistik të ekonomisë qarkore në Kosovë. Fokusi i strategjisë është më tepër në menaxhimin e pasojave nga ekonomia lineare, duke paraparë rritjen e efikasitetit në menaxhim të mbeturinave, reciklimit, pyllëzimin dhe rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë së ripërtëritshme, se sa në zhvillimin e ekonomisë qarkore, që do të largonte aktivitetin ekonomik nga përdorimi i resurseve finite dhe të parandalonte që nga fillimi krijimin e pasojave nga veprimet e zhvillimit të shpejtë, duke u përqendruar në dizajnimin efikas të intervenimeve.

Programi i Kosovës për reforma në Ekonomi (PKRE) 2019-2021, gjithashtu nuk e përmend termin ekonomi qarkore dhe është i përqendruar kryesisht në zhvillimin e ekonomisë lineare. Rekomandohet që në programin PKRE të ketë reforma konkretisht të specifikuar për zhvillimin e ekonomisë qarkore, me masa dhe aktivitete që përputhen me qasjen e modelit ekonomik qarkor në dizajnimin e shoqërive, produkteve dhe shërbimeve që benefitet në afatgjatë i kanë të qëndrueshme dhe dëmet minimale.

Legjislacioni – Ligjet do të duhej adaptuar që të inkuadrojnë konceptin dhe terminologjitë përkatëse të ekonomisë qarkore dhe të ofrojnë lehtësira për personat, entitetet (fitimprurëse dhe jofitimprurëse) që janë duke kontribuar apo planifikojnë të kontribuojnë në stimulimin e ekonomisë qarkore në vend. Ligjet mbi ndërmarrjet sociale, zonat ekonomike dhe investimet e huaja, do të duhej të parashihnin lehtësira, që do t'i stimulonin entitetet që të nxisin ekonominë qarkore në Kosovë. Ligji për mbeturinat edhe pse parasheh evitimin, reduktimin dhe parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis, nuk e ka fokus kyç eliminimin e tërësishëm të konceptit të mbeturinave dhe nuk e përmend ekonominë qarkore. Ligji për Investimet Strategjike do të duhej amandamentuar që të parasheh lehtësira për investitorët dhe investimet të cilët do të ndihmonin në stimulimin e ekonomisë qarkore në vend.

Ekonomia – Nevojiten intervenime konkrete në nivelin mikroekonomik dhe makroekonomik, për të orientuar zhvillimin ekonomik afatgjatë në drejtimin e një ekonomie më të qëndrueshme qarkore. Stimulimet financiare në formë të subvencioneve apo pagesave direkte të popullata, mund të sjellin ndryshim në mentalitet e sjellje dhe të çojnë drejt rezultateve konkrete që mund ta shtyejnë zhvillimin e ekonomisë qarkore përpara. Incentivat fiskale dhe jo-fiskale, që do të mund të ofronin garancione në investime të caktuara, që mund të stimulojnë ekonominë qarkore dhe të ndihmojnë në inkurajimin e bizneseve të ndërmarrin veprime në investime që rrisin efikasitetin e zinxhirit të prodhimit, konsumimit dhe eliminojnë hedhjen, do të mund të kontribuonin në një tranzicion më të shpejtë në këtë model ekonomik. Lehtësirat e tjera për të bërë biznes me qasje qarkore, mund të rikthejnë fokusin e zhvillimit ekonomik afatshkurtër, në zhvillim më të qëndrueshëm në afatgjatë.

Teknologjia – Hovi i zhvillimit teknologjik botëror është duke i dhënë shpresë dhe shpejtësi zhvillimit të ekonomisë qarkore. Duke marrë parasysh se teknologjitë e reja në vendet në zhvillim e sipër marrin kohë për t'u mishëruar të masa, rekomandohet që bizneseve në Kosovë t'u mundësohet qasje më e lehtë në teknologjitë inovative përmes mbështetjes në lehtësimin e bërit të biznesit me vendet më të zhvilluara. Kështu individët dhe entitetet e tjera do të mund të sigurojnë zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve që përputhen me pritjet dhe vlerat e ekonomisë qarkore, dhe duhet të planifikohen strategjikisht në nivelin nacional dhe lokal.

Infrastruktura – Duhet adaptuar planifikimet e qyteteve, fshatrave dhe zonave ekonomike, por edhe të lidhjeve strategjike me shtetet fqinje dhe rajonin, për ta lehtësuar, nxitur dhe stimuluar zhvillimin e ekonomisë qarkore vendore dhe rajonale. Për të mundësuar krijimin dhe dizajnimin e produkteve që përdorin lëndë të para të ripërdorshme dhe jo të dëmshme për ripërdorim, duhet të ndërmerren masa për mbrojtje, si dhe për revitalizim të tokave dhe hapësirave që mundësojnë zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, duke mimikuar proceset natyrore, pa dëmtuar ambientin. Hapësirat ekzistente boshe që janë degraduar apo janë të

papërdorshme janë mundësi e mirë për t'u transformuar nga reformat konkrete që mund të ndërmerren përmes partneriteteve publiko-private për të zhvilluar ekonominë qarkore dhe për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në produkte, shërbime dhe procese inovative që drejtohen nga modelet e ekonomisë qarkore.

Edukimi – Institucionet shtetërore akademike do të duhej të fusnin kurrikulë praktike shumëvjeçare mbi ekonominë qarkore në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Në ndërkohë, shkollat e mesme dhe të larta private, rekomandohet të adaptohen me shpejtësi dhe të inkuadrojnë konceptet e ekonomisë qarkore në lëndët e të gjitha profileve, pa dallim, si element thelbësor, që orienton kahjen e veprimit dhe ndërveprimit me natyrën dhe botën. Organizatat jo-qeveritare që merren me edukim, rekomandohet që urgjentisht të punojnë në krijimin e trajnimeve virtuale dhe jo-virtuale, punëtorive, konferencave e aktiviteteve inovative edukative, që motivojnë, inspirojnë dhe ngjallin tek të rinjtë dëshirën për të krijuar e dizajnuar produkte e shërbime në përputhje me ekonominë qarkore. Qeveritë lokale dhe qendrore do të duhej të udhëheqin në promovimin dhe të harmonizojnë prokurimin publik me modelet e ekonomisë qarkore. Kompanitë private rekomandohet të mbajnë trajnime për punëtorët për krijimin e produkteve dhe shërbimeve, si dhe për transformimin e zinxhirit të prodhimit dhe konsumimit në harmoni me vlerat dhe qasjen e ekonomisë qarkore ndaj ambientit.

Arti & Kultura – Projektet artistike dhe muzikore mund të kontribuojnë jashtëzakonisht shumë në krijimin e një kulture që vlerëson zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend dhe i shtyen vlerat e mirëfillta shoqërore drejt mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit. Rekomandohet të mbështeten projektet nga artistët, muzicentët, inovatorët e blogerët vendor që në vete ndërthurin elemente të ekonomisë qarkore apo promovojnë një qasje të shëndoshë dhe gjithëpërfshirëse ndaj jetës dhe mjedisit që inspiron ndryshime kulturore në masë. Sygjerohet që të krijohen “maker-space”, që do t'u ofronin qasje artistëve e inovatorëve në transformimin e ambienteve, produkteve, shërbimeve dhe zinxhirit të prodhimit, konsumimit dhe eliminimit të hudhjes nga mënyra e jetesës sonë.

Përshtypjet nga Konferenca e Parë Nacionale mbi Ekonominë Qarkore, mbajtur më shtator 2019 në Prishtinë

Në konferencën e parë nacionale mbi ekonominë qarkore në Kosovë, të mbajtur në KosovaLive, në Prishtinë, më 25 shtator 2019, me përfaqësues nga niveli nacional, lokal, sektori privat, dhe ai jo-fitimprurës, u diskutua se çfarë është duke u bërë për zhvillimin e këtij modeli ekonomik në vend. Diskutimet nga të gjitha nivelet përputheshin me gjetjet e hulumtimit dhe e reflektonin situatën me zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend si shumë të mangët, e po thuajse jo ekzistente.

Për zhvillimet në nivelin nacional dhe lokal u diskutua me ministrin për Zhvillim Ekonomik, Valdrin Ljeka dhe anëtarën e parlamentit, ish-kryetarën e komunës së Gjakovës, dhe ish-ministrën e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari Lilen, të cilët treguan se Kosova nuk ka strategji për zhvillimin e ekonomisë qarkore dhe asnjëra nga partitë politike nuk e ka as në programin e tyre.

Mungesa e incentivave shtetërore që stimulojnë ekonominë qarkore gjithashtu u theksua të jetë një nga pengesat e tjera për zhvillimin e këtij modeli. Nevoja për të mbajtur dialog të hapur dhe aktiv ndërmjet bizneseve dhe qeverive u theksua të jetë shumë jetike për zhvillimin e ambientit të favorshëm për nxitjen e ekonomisë qarkore në vend.

U theksua roli i rëndësishëm që kanë organizatat e asociacionet e bizneseve në vend, të cilat sipas folësve që përfaqësonin sektorin privat dhe atë jo-fitimprurës, janë duke hezituar të bëjnë ndryshime për shkak të shumë faktorëve që i pamundësojnë të investojnë në avansim.

Në panelin e përbërë nga Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Nora Latifi Jashari, drejtoreshë ekzekutive e Instiutit GAP, dhe Driton Bajraktari, drejtor ekzekutiv i Kosova Social Enterprise Association u ritheksua nevoja e koordinimit më të mirë të të gjitha palëve për të krijuar iniciativa për promovimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend.

Folësit gjithashtu theksuan se mungesa e iniciativës nga sektori privat ndikohet nga ligjet e dobëta, qasja në inovacion, nga stafi i pakualifikuar, nga kostoja e lartë për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve që e mundësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkore, si dhe nga niveli i lartë i korrupsionit.

Përfaqësuesi nga sektori privat, Visar Ramajli, foli për iniciativën e KIVO dhe Reks, që kanë investuar në impiant të “reciklimit të brendshëm të mbetjeve të kompanisë që ngelin pas proceseve të prodhimit të produkteve të plastikës, dhe si 100% të mbetjeve gjatë procesit të prodhimit reciklohen dhe rifuten në prodhim, duke rezultuar kështu me 0% mbetje”. Krahas kësaj, impianti përdorë sistem të mbyllur të ujit dhe sistem të ftohjes të quajtur “freecool” për ftohje që kursen përdorimin e energjisë elektrike, duke aktivizuar kompresorët e instaluar në fabrikë. Shembulli i KIVO dhe Reks tregon që mundësia për rritjen e efikasitetit dhe eliminimit të mbetjeve, përmes teknologjisë inovative është e mundur edhe në Kosovë, por disa nga kufizimet që ndikojnë në mosrealizimin e iniciativave të tilla janë mungesa e dijes dhe gatishmërisë së udhëheqësve të bizneseve, mungesa e garancioneve shtetërore për investime të tilla, fuqia e vogël blerëse dhe kapitali i bizneseve për investime të tilla, si dhe vështirësitë në qasje të lehtë në teknologji, për shkak të limitimeve në qarkullim të lirë.

Një nga arsytet se pse nuk investohet më tepër në modele të tilla në Kosovë, që u identifikua nga përfaqësuesi i sektorit privat, Visar Ramajli ishte se investimet e tilla janë shumë të kushtueshme dhe kompanitë lokale nuk kanë aftësi financiare për një investim të tillë afatgjatë. Në goftë se kthimi i investimit nuk është i sigurt dhe i majmë, një investim i tillë nuk është i justifikuar për kompanitë, sidomos duke marrë parasysh se shteti nuk ofron kurfarë garancioni.

Konferenca nacionale mbi ekonominë qarkore, rikonfirmoi gjetjet e hulumtimit, që pasqyrojnë mungesën e njohurisë së përgjithshme të popullata dhe mungesën e strategjisë nacionale për zhvillimin e ekonomisë qarkore në vend. U ritheksua se koncepti i ekonomisë qarkore në Kosovë është ende i përqendruar në reciklim dhe në menaxhim të mbetjeve, duke mos hyrë në thelbin e nocionit i cili ka për qëllim transformimin e zinxhirit të prodhimit e konsumimit, me një objektivë përfundimtare të eliminimit të konceptit të hudhjes, dhe përfundimisht transformimit të mënyrës së jetesës sonë.

Rreth News Agency KosovaLive (KosovaLive)

Misioni i KosovaLive është të përdorë median si mjet dhe promovues të edukimit, dialogut dhe barazisë. Puna e KosovaLive udhëhiqet nga tri shtylla.

Media si mjet dialogu: KosovaLive fokusohet në krijimin e projekteve që ndërlidhen me përdorimin e medias si mjet dialogu ndërmjet komuniteteve ndëretnike brenda vendit dhe rajonit. KosovaLive punon në ndërtimin e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe paqes afatgjate. Nga forumet e nivelit të lartë, që përfshijnë politikanë, gazetar, liderë të komunitetit dhe personalitete, deri te konferencat dhe shkëmbimet e gazetarëve, KosovaLive ka qenë dhe mbetet lider në thyerjen e akullit në bisedimet ndër-etnike, që nga ditët e hershme të kohës pas konfliktit në rajon.

Media si mjet Edukimi: Duke përdorur mediat inovative të komunikimit, KosovaLive punon në krijimin e aftësive për mendim kritik dhe edukim medial të rinjtë, gratë, shërbyesit civil, zyrtarët e lartë dhe gazetarët. Projektet ndërthurin një gamë të gjerë të temave nga Dezinformimi, Votimi, Angazhimi Publik, Fuqizimi i Grave, Ekonomia Qarkore, e deri tek Mendimi Dizejnues, e Ndërmarrësia Sociale. Partneritetet me dekada, me institucionet e edukimit të lartë në Kosovë dhe SHBA., i mundësojnë KosovaLive-it të edukojë dhe të angazhojë individë me prapavijë të ndryshme në aktivitete, ngjarje, programe dhe iniciativa shumëgjuhëshe dhe multi-nacionale.

Media si Mjet i Barazisë: Programet inovative për rritjen e barazisë shoqërore, ekonomike dhe gjinore, kanë përmirësuar jetërat e qindra të rinjëve anëmbanë vendit. Byroja edukative dhe profesionale e vajzave në kuadër të KosovaLive, e cila është fituese e çmimeve nacionale dhe ndërkombëtare, dhe pjesë e rrjetit me renome botërore GlobalGirl Media, fokusohet në fuqizimin e grave përmes programeve që rrisin angazhimin publik dhe ekonomik të grave, përmes mediave. (www.kosovalive.org)

Rreth Autores

Annea Hapçiu është këshilltare për inovacion në KosovaLive. Ajo gjithashtu është themeluese e byrosë edukativo-profesionale të vajzave GlobalGirl Media Kosova në KosovaLive, pjesë e rrjetit ndërkombëtarë të byrove mediale të vajzave GlobalGirl Media, si dhe themeluese e studios së parë të yogas në Kosovë, N'Yoga. Studimet master i përfundoi në Ndërmarrësi Sociale, me fokus në media për ndryshim shoqërorë, në Universitetin Amerikan në Washington D.C., përmes bursës së Kosovo American Education Fund (KAEF), ndërkaq studimet Bacheloret të Shkencave në Administrim Biznesi, me fokus në Ndërmarrësi dhe Marketing i përfundoi në Universitetin e Dayton-it në Ohio, në SHBA duke diplomuar si John W. Berry Scholar. Për punën e saj në edukim, barazi gjinore dhe projekte artistike u nderua nga shteti i New York-ut në vitin 2017. Nga UN Women u listua si një nga top aktivistet në vitin 2018 dhe top inovatorët në vitin 2019 për Europë dhe Euroasi. Projekti i saj "A journey of branding through yoga" u prezantua në TEDxWomenPrishtina në vitin 2013. Ajo gjithashtu është recenzente për fushat e marketingut dhe brandingut shtetëror, në revistën akademiko-shkencore International Marketing Review.

Referencat

- Benyus, Janine M. *Biomimicry: Innovations Inspired by Nature*. Harper Collins Perennial, 2002.
- Bornstein, David, and Susan Davis. *Social Entrepreneurship: What Everyone Needs to Know*. Oxford University Press, 2010.
- Botezat, Elena Aurelia, et al. *An Exploration of Circular Economy Practices and Performance Among Romanian Producers*. Sustainability MDPI, 6 Sept. 2018.
- Buck, Matthias, et al. "Phasing in Renewables Towards a Prosperous and Sustainable Energy Future in Kosovo: Challenges and Possible Solutions." *BalkanGreenFund*, July 2018,
- "Circular Economy - UK, USA, Europe, Asia & South America - The Ellen MacArthur Foundation." *Ellen MacArthur Foundation*
- Eggers, William D., and Paul Macmillan. *The Solution Revolution: How Business, Government, and Social Enterprises Are Teaming up to Solve Society's Toughest Problems*. Harvard Business Review Press, 2013.
- Kelley, Tom, and David Kelley. *Creative Confidence: Unleashing the Creative Potential within Us All*. 1st ed., Crown Business, 2013.
- "Ligji Nr. 04/L-220 Për Investimet e Huaja." *Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës*, Kuvendi i Republikës Së Kosovës, 12 Dec. 2013.
- "Ligji Nr. 05/L-079 Për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës", *Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës*, Kuvendi i Republikës Së Kosovës 8 Feb. 2017
- "Ligji Nr. 04/L-060 Për Mbeturina." *Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës*, Kuvendi i Republikës Së Kosovës, 29 June 2012
- "Ligji Nr. 06/L-022 Për Ndërmarrjet Sociale." *Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës*, Kuvendi i Republikës Së Kosovës, 26 Nov. 2018,
- "Ligji Nr. 04/L-159 Për zonat ekonomike." *Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës*, Kuvendi i Republikës Së Kosovës, 14 Feb. 2013.
- McDonough, William, and Michael Braungart. *The Upcycle. Beyond Sustainability - Designing for Abundance*. 1st ed., North Point Press, 2013.
- McDonough, William, and Michael Braungart. *Cradle to Cradle: Remaking the Way We Make Things*. North Point Press, 2002.
- Musa, Dora, and Burim Ejupi. "Waste Management in Kosovo: Identifying Challenges in the Sector." *INDEP*, May 2018.
- "Programi i Kosovës Për Reforma në Ekonomi (PKRE) 2019-2021." *Konsultimet.rks-Gov.net*, Republika e Kosovës.
- "Qëndrueshmëria Ekonomike e Kosovës (Sfidat, Politikat dhe Mundësitë)" *www.riinvestinstitute.org*, Instituti Riinvest, Dec. 2005.
- Shkaqet e Ndotjes Së Ajrit*. Instituti Gap, Nëntor. 2017.
- "Strategjia Kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH)." *www.kryeministri-Ks.net*, Republika Kosova - Republic of Kosovo, Jan. 2016.
- Strategy for the Transition to Circular Economy in the Municipality of Maribor*. Wcycle Institute Maribor, July 2018.
- Sustainable Development Indicators in Kosovo*. Institute for Development Policy - INDEP, Sept. 2018.
- The Circular Economy: Reconciling Economic Growth with the Environment*. Institut Montaigne, Nov. 2016.
- Yunus, Muhammad, and Karl Weber. *Building Social Business: The New Kind of Capitalism That Serves Humanity's Most Pressing Needs*. Public Affairs, 2011

Citimi i studimit:

Hapçiu, Aneta. *Ekonomia Qarkore në Kosovë: Hulumtim mbi njohurinë dhe perceptimet e përgjithshme rreth konceptit të ekonomisë qarkore në Kosovë*. News Agency KosovaLive (KosovaLive), 2019.

Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e News Agency KosovaLive (KosovaLive) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian, i Env.net apo ATRC.

Të drejtat autoriale © 2019. News Agency KosovaLive (KosovaLive)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të News Agency KosovaLive (KosovaLive).

Ky hulumtim dhe studim u financua nga:



Ky projekt u mbështet nga:



Ky studim dhe raport u punua nga News Agency KosovaLive:

